



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 14 janar 2022, në mbledhjen e IV-të (katërt) – mbledhje e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e Komunës së Podujevës.

Mbledhjen e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës përveç z.Gazmend Islami i cili mungoi,

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, z.Fatlum Osmani U.D. i drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, z.Driton Veliu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, znj.Bahrie Shatrolli – Mehmeti, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave elektronike dhe të shkruara lokale dhe më gjerë, përfaqësues të KFOR, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera, theksoi, fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse konstatoj se prezent janë 34 anëtar ndërsa mungon një anëtar i Kuvendit, andaj kemi numër të mjaftueshëm për kuorum dhe mund të vazhdojmë me punë. Thirrja e kësaj mbledhje së bashku me materialin përkatës u është dërguar me kohë në e-maillet e juaja, prandaj e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

Njëzëri mbështetet rendi i ditës, respektivisht vazhdimi i seancës sipas pikave të rendit të ditës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë.

1. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth propozim vendimit për projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023 – 2024, ndër të tjera theksoi, buxheti i vitit 2022, është i planifikuar në përputhje me procedurat buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave përmes Qarkoreve Buxhetor për vitin 2022.

Buxheti është njëri prej dokumenteve më të rëndësishme në të cilin paraqiten objektivat e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore me anë të cilave synohet arritja e objektivave zhvillimore të Komunës, e që objektivat e Komunës së Podujevës janë përmirësimi i infrastrukturës në qytet dhe fshatra, krijimi

i një qyteti më të zhvilluar evropian urbanistik, ngritja e nivelit të arsimit duke krijuar kushte më të mira të arsimit dhe duke e lidhur me ekonominë, zhvillimi i shëndetësisë duke krijuar shërbime cilësore për qytetarët, zhvillimi i kulturës dhe i sportit, ruajtja dhe përmirësimi i ambientit, zhvillimi i bujqësisë, zhvillimi i turizmit etj.

Të gjitha këto objektiva janë inkuadruar në buxhetin e vitit 2022 në kuadër të njësive buxhetore të cilat i ka Komuna e Podujevës. Buxheti i vitit 2022 duke u bazuar në limitet buxhetore të Qarkores së dytë Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave për Komunat është 23,444, 521.00€, nga kjo shumë buxhetore 12,470,000.00€, janë në kategorinë e pagave, 2,650,000.00€, janë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, 420,000.00€, janë shërbime komunal, 960,000.00€, janë subvencione, 9,689,521.00€, shpenzime kapitale. Në buxhetin e vitit 2022, për dallim nga buxhetet e viteve të kaluara i është jep prioritet fushave jetike për zhvillimin ekonomik dhe social si arsimit, zhvillimit ekonomik, shëndetësisë, kulturës dhe sportit si dhe projekteve zhvillimore në fushën e infrastrukturës urbane. Sa i përket prioritetëve të këtyre fushave në krahasim me vitet e kaluara më së miri shpjegohen përmes numrave të shumave buxhetore të planifikuara për investime në këto fusha në krahasim me vitin 2021. Më lejoni t'i shkoqis disa shembuj nga ky krahasim, në arsim në kodin buxhetor përmirësimi i infrastrukturës shkollore për vitin 2022 parashihen investime në vlerë 444,218.00€, për dallim nga vitin 2021 që kanë qenë 97,582.00€, pra kemi 4.5 herë më shumë investime në institucionet arsimore, është e qartë se buxheti i Komunës së Podujevës nuk është rritur për 4.5%, mirëpo i është dhënë prioritet sektorit të arsimit, gjithashtu në kategorinë e mallrave në sektorin e arsimit për vitin 2021 që kanë qenë të ndara 570,426.00€, kurse për vitin 2022 do të jenë 928,656.00€, pra shprehur në përqindje është 62.8%, më shumë. Në kategorinë e subvencioneve për bursa për nxënës dhe student nga 50,000.00€ sa kanë qenë në vitin 2021, për vitin 2022 do të jenë 100,000.00€, pra kemi një dyfishim të fondeve për bursa në sektorin e arsimit.

Në fushën e shëndetësisë ka projekte tepër të rëndësishme që do të ndikojnë në mënyrë radikale në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore e që në buxhetin e viti 2022 parashihet ndërtimi i QMF III, në vlerë rreth 3,000,000.00€ në bashkëfinancim me Shoqatën nga shteti i Katarit ku Komuna e Podujevës ka ndarë një shumë më të vogël buxhetore, pastaj renovim i objekteve shëndetësore, furnizim me pajisje mjekësore dhe të gjitha këto projekte janë të inkuadruara në buxhetin e viti 2022. Në kategorinë e subvencioneve në fushën e shëndetësisë parashihet ndihmë financiare për pacientët që vuajnë nga sëmundjet kronike e që kemi dyfishim të fondeve nga 50,000.00€, në 100,000.00€.

Në fushën e zhvillimit ekonomik janë planifikuar mjete buxhetore për vitin 2022 në vlerë 200,000.00€, në kategorinë e shërbimeve kapitale përkatësisht në ndërtimin e zonës ekonomike në bashkëfinancim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe bashkë me disa veprime të tjera të cilat janë duke u ndërmarrë për vitin 2022, do të thotë kemi zonën industriale në Komunën e Podujevës. Për herë të parë kemi fondin për subvencionimin e kredive prodhuese në vlerë 100,000.00€, dhe gjithashtu 40,000.00€ për subvencionimin për grante në bashkëfinancim me donatorë, grante për biznese është fjala.

Në fushën e kulturës dhe sportit vetëm për investime kapitale do të jetë një buxhet në vlerë 350,000.00€, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë të planifikuara 223,550.00€, pra kemi një rritje prej 56.5% vetëm në kategorinë e investimeve kapitale, në fushën e kulturës parashihen fonde për fillimin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës që do të jetë në bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit buxhet për ndërtimin e fushave rekreative sportive, galerinë e arteve dhe për projektin shumë të rëndësishëm siç është ndarë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit parashihen projekte zhvillimore ku qytetit dhe Komunës tonë do t'i japin një dimension tjetër të zhvillimit në synimet e saj për një qytet të zhvilluar urban me një plan urbanistik, ambient të pastër dhe hapësira rekreative.

Sa i përket projekteve që parashihen për vitin 2022, disa projekt më madhore që mund t'i cekim janë ndërtimi i rrugëve "Skënderbeu" dhe "Xhemajl Mustafa", në bashkëfinancim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralja Podujevë-Prishtinë me rrugën "Vëllezërit Frashëri", asfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra, zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve në vlerë 235,000.00€, investim në rrjetin e kanalizimit etj.

Të nderuar asamblast prioritetet që janë të theksuar në këtë buxhet janë arsimi, shëndetësia, ekonomia, kultura dhe disa projekte më madhore në fushën e infrastrukturës e bëjnë këtë buxhet më të mirin gjatë këtyre 20 viteve, andaj ju ftojme që ta mbështetni këtë buxhet.

z.Valon Demolli, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024, është i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve për 3 vitet e ardhshme, duke e ditur peshën e këtij buxheti ka qenë e rrugës që Ekzekutivi i Komunës të na ftoj neve si asamblast për ta diskutuar këtë buxhet që është i të gjithë qytetarëve dhe jo vetëm i pushtetit ku përmes realizimit të projekteve të ndryshme do të përmirësohej mirëqenia e të gjithë qytetarëve, pa dallime politike.

Ky propozim buxhet është i hartuar njëanshëm nga pushteti dhe na është servuar si i tillë andaj ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së nuk do ta përkrahim këtë buxhet.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje do të flas z.Bahri Selimi.

z.Bahri Selimi, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, para vetës kemi një dokument i cili është më i rëndësishmi për Komunën tonë, një dokument për të cilin kemi folur gjatë, kemi diskutuar gjatë, kemi marrë propozime nga persona dhe subjektet tjera politike dhe në fund e kemi servuar kështu para jush. Prioritet iu është dhënë fushave për të cilat është menduar se në një formë kanë qenë të diskriminuara nga qeverisjet e kaluara e këto fusha të cilave iu është dhënë prioritet, shumë mirë më herët i sqaroj drejtori i DBF-së, këto fusha janë arsimi, shëndetësia, ekonomia, bujqësia dhe kultura. Kur flasim për arsimin ne gjithëherë kemi pranuar kritika të ndryshme se infrastruktura në arsim është jashtëzakonisht jashtë standardeve të arsimit që kanë ndikuar shumë në mësim nxënien e nxënësve por edhe në kushtet e mësimdhënies. Është ndarë buxhet për përmirësimin e infrastrukturës shkollore ashtu siç u përmend mbi 4% më shumë se vitin e kaluar ku 97.000.00€ sa kanë qenë vitin e kaluar tashmë i kemi 444,000.00€ dhe shpresojmë se jemi në rrugë të mbarë që infrastruktura shkollore njëherë e mirë të marrë formë dhe të duket ashtu siç i takon shkollës dhe arsimit.

Në sektorin e arsimit është bërë dyfishimi i mjeteve për bursa, ne e dimë që shumë student dhe nxënës për tej që kanë shumë aftësi për mësim i kanë kushtet ekonomike jo të mira dhe e kanë më vështirë të arrijnë atë çfarë e kërkojnë dhe në këtë kategori është dyfishuar buxheti nga 50,000.00€, në 100,000.00€.

Në fushën e shëndetësisë ka projekte tepër të rëndësishme që do të ndikojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në mënyrë radikale, për vitin 2022 parashihet ndërtimi i QMF III, në vlerë prej 1.2 milion € në bashkëfinancim me shtetin e Katarit, renovimi i objekteve shëndetësore, furnizimi me pajise mjekësore, në kategorinë e subvencioneve në fushën e shëndetësisë përfshihet ndihmë financiare për pacientët me sëmundje kronike ku kemi dyfishim të fondeve nga 50,000.00€ në 100,000.00€.

Në fushën e zhvillimit ekonomik duke marrë për bazë që ekonomia është shtylla kryesore e zhvillimit të një vendi, të një shteti apo të një Komune kemi planifikuar 200,000.00€ së bashku me fondet e ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe veprimet e tjera që do të ndërmerren për vitin 2022 do të kemi zonën industriale, është bërë shumë dhe është përfolur shumë për zonën industriale, ka pasur mjete të ndara edhe më herët sikurse në vitin paraprak që kanë qenë 30,000.00€, por nuk janë jetësuar asnjëherë, tashmë në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse janë ndarë 200,000.00€, dhe do të fillojë ndërtimi i zonës industriale.

Për herë të parë do të kemi fondin e subvencionimit për kreditë prodhuese në vlerë prej 100,000.00€. Në fushën e kulturës dhe sportit është paraparë një rritje buxhetore, vetëm për investime kapitale do të ketë buxhet në vlerë 350,000.00€, ndërsa në vitin paraprak kanë qenë të ndara 223,000.00€, pra ka një rritje të buxhetit prej 56%.

Në fushën e kulturës parashihen fonde për fillimin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës dhe në bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit do të ndërtohen fusha rekreative sportive, galeria e arteve si dhe projekte shumë të rëndësishme që asnjëherë më parë kjo Komunë nuk i ka pasur. Fushat tjera janë përafërsisht të njëjta sa i përket Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim dhe të ngjashme prandaj unë ju ftoj që duke i parë këto rritje dhe duke parë këtë buxhet që me të vërtetë për herë të parë është më ndryshe se sa buxhetet e mëparshme ju ftoj që ta votojmë së bashku dhe t'i hapim rrugë zhvillimit dhe ecjes përpara të Komunës tonë.

z.Bashkim Sylaj, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, është e vërtetë se në projektbuxhetin e vitit 2022 i është dhënë më shumë prioritet sektorit të arsimit, ekonomisë dhe shëndetësisë dhe ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së i kemi pasur disa vërejtje mirëpo në takim me drejtorin e DBF kemi marrë sqarime lidhur me disa investime nëpër fshatra për të cilët ne kemi menduar se janë anashkaluar. Sqarimet e drejtorit të DBF kanë qenë se një pjesë e të hyrave vetanake do të rialokohet në buxhet dhe këto mjete do të shkojnë për ato fshatra, sqarime kemi kërkuar edhe për numrin e çerdheve që nuk janë të përfshira në projektbuxhet mirëpo ndërtimi i disa çerdheve është paraparë nga niveli qendror, kështu që ne jemi pro votimit të këtij buxheti sepse edhe ashtu në kohë jemi vonuar.

Një projekt që më ka lënë përshtypje është ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralja Podujevë-Prishtinë deri te rr. "Vëllezërit Frashëri", sepse në të kaluarën kemi pasur projekte të tilla që kanë zgjatur 2 ose 3 vite por shpresoj dhe besoj se ky projekt do të realizohet ashtu siç është planifikuar nga Ekzekutivi i Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot kemi para vetës dokumentin më të rëndësishëm të viti kalendarik që ka të bëjë me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe realizimin e projekteve të cilat janë paraparë për vitin 2022, para se të jap mendimin tim për vërejtjet dhe lëvdatat që gjithmonë ka vend për to, më bëri ta bëj një digresion që u cilësua nga parafolesit si buxheti më i mirë i 22 viteve të fundit, pa dashur të minimizoj duhet të them diçka që është një e vërtetë që është një specifikë e këtij buxheti në këto 22 vitet e fundit, dhe ajo është se po miratojmë një buxhet jashtë afateve të rregullta ligjore dhe kjo për herë të parë pas 22 viteve, pa dashur të pyes dhe pse ka ardhur deri këtu, por vetëm desha të japë këtë specifikë se është për herë të parë pas 22 viteve.

Mbledhja e IV-të e jashtëzakonshme e mandatit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në rendin e punës ka propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës për vitin 2022, si fillim kam vërejtjet e mia se kjo mbledhje nuk është e përgatitur konform kriterëve që janë të normuara në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Statutin e Komunës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, pra është një mbledhje e jashtëzakonshme dhe në bazë të ligjit është përcaktuar 3 ditë pune që këshilltarët e Kuvendit të pajisen me material me të cilin do të debatojnë si dhe rëndësinë që e ka ky projekt buxhetit. Po flas në vetën e parë edhe pse e di që nuk jam i vetmi që kam këtë mendim, ne kemi pasur një material të adresuar në mënyrë elektronike mirëpo nuk kemi pasur material fizik që Rregullorja e parasheh të kemi material fizik, është e vërtetë e madhe kjo ngase dëgjove edhe dje në mbledhjen e KPF-së që praktikantët e më vonshme prej vitit 2013-2014, me një dakordim të Ekzekutivit dhe kuvendarëve është arritur që për shkak të kursimit të letrës dhe kohës këshilltarët të pajisen me aparaturë elektronike në mënyrë që materiali të dërgohet në mënyrë elektronike.

Në këtë përbërje të re të Kuvendit për disa këshilltar të cilit e vazhdojnë mandatin nuk e di por sigurisht ata janë këtu dhe deklarohen vetë që i kanë ato pajisje elektronike, mirëpo pjesa dërmuese e

këshilltarëve nuk i kemi këto pajisje. Ne krejt çfarë kemi mundur të bëjmë është se materiali na ka ardhë në një adresë elektronike dhe vetë jemi gjindur duke dalë në skriptore për ta përgatitur materialin e kësaj mbledhje. Kjo të jetë një vërejtje dhe të mos përsëritet më, ky Kuvend para se të fillojë me punë është dashur të bëjë një zgjidhje uniforme për të gjithë anëtarët e Kuvendit sepse të gjithë ne këtu jemi përfaqësues të qytetarëve dhe kemi marrë besimin e tyre, kjo vërejtje në veçanti shkon në adresën e Kryesuesit të Kuvendit sepse ai është përgjegjës që në rend të parë të kujdeset për punën dhe kushtet e kuvendarëve në bashkëpunim me administratën e Komunës.

Më bëri përshtypje fjalia e z.Bahri Selimi, këtë që po e them të mos merret si politikë por si do që të jetë ishim koleg në një mandat tjetër dhe atëherë rolet i kishim të ndryshme dhe Kryesuesi dhe ne e kishim një fjali të zakonshme që e përdornim, diskriminim, diskriminim në kuptimin e ndarjes së buxhetit, gjegjësisht në gjithë përfshirjen e lokaliteteve të Komunës tonë, dhe më duhet ta ceku se e njëjta praktikë e kemi edhe tani, ndoshta mund të jetë më e vogël ose më e madhe, por e njëjta është. Tani po e shfletoj dhe po mundohem ta tregoj ku dhe pse, në rend të parë ne kuvendarët po mendojmë të miratojmë buxhet për të gjithë të tjerët dhe s'ka si të mos më bie në sy Zyra e Kuvendit ku ne jemi, kisha dashur të shohë për këtë vit dhe për 3 vitet e ardhme por që nuk janë të parapara mjete për asnjë program dhe as diçka tjetër përveç pagave fikse si dhe Komitetet tjera nuk janë të parapara, që do të thotë se nuk ka ndarje dhe vijë buxhetore për Kuvendin e Komunës.

Është e vërtetë se kemi disa projekte të mira që për herë të parë ceket zona ekonomike që edhe këtë herë e kemi të projektuar, andaj uroj që ky proces të mos mbetet në letër sepse në letër të shkruar e kemi pasur edhe më herët por të merren hapat e parë të realizimit të saj. Projektet prioritare të cilat i kemi para vetës një vërejtje e imja është se nuk janë të specifikuara ku dhe kur por janë të përgjithësuara në lokalitete, mirëpo ne e dimë që Komuna jonë i ka rrugët e emërtuara andaj të dihen adresat e tyre dhe këto projekte është dashur të jenë të specifikuara. Me theks të veçantë do të ndalem te projektet me trotuare, vij nga një lokalitet i anës jugore të Komunës dhe kam menduar se nga ajo anë që vijnë pushtetarët shkojnë edhe investimet, mirëpo kësaj radhe nuk na ka dalë mirë zotëri Kryetar.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, i përgjigjet parafolësit për pjesën e fundit të diskutimit të tij duke theksuar se, po japim shembull të mirë tani.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, shembull të mirë jeni duke dhënë por në dëm të qytetarit zotëri Kryetar, po e marr vetëm një shembull që të gjithë e dinë, a ka rrugë më të rëndësishme dhe më të rrezikshme se rruga magjistrale Podujevë-Prishtinë, nuk ka, a ka rrugë më frekuentuar se kjo rrugë, nuk ka, a jeni të gjithë dëshmitarë që nxënësit prej Lagjes së Humollëve të fshatit Lupç i Poshtëm e të fshatrave Shakovicë dhe Lluzhan që 22 vite nuk kanë trotuare, dhe brenda mundësive kërkoj që ky projekt të realizohet sepse potencialisht po e them, në mënyrë tjetër rrezikohet një qytetar dikund tjetër kurse tjetër mënyrë rrezikohet këtu ku e ceka.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se në atë rrugë janë duke u zhvilluar punime dhe nuk mundemi ne që tani ta rregullojmë trotuarin dhe të njëjtin ta largojmë pastaj pas dy muajve.

z.Naim Çunaku, theksoi, këtë çështje në ç'do mandat e kam potencuar dhe a e dini se cila ka qenë përgjigja e të gjithë kryetarëve të mëparshëm, e kemi ndërmend ta bëjmë autostradën, mirëpo po të dalim në Komunën simotër që është Prishtina, sepse edhe andej kalon autostrada, ka kohë që trotuaret i kanë rregulluar. Kërkesë tjetër kam nga banorët e lokalitetit për rrugën lidhëse të fshatrave Bellopojë Tërnavë, konkretisht te shkolla ku kemi parë disa aksidente fatkeqësisht me fatalitet si shkak i mungesës së trotuarit dhe për habi asnjërin prej këtyre projekteve nuk i kam hasur në projektbuxhet.

Duke dashur që të gjitha ato anë të mira që i përmenda të jenë të realizuara dhe jo vetëm të mbesin në letër uroj që të realizohen dhe t'ju lehtësohet jeta qytetarëve.

I nderuari Kryetar, po i cekë me emra lokalitetet nëpër të cilat janë ndërtuar trotuare e këto lokalitete janë fshatrat Kërpimëh, Kunushec, Gërdoc, Kaçybeg, Shtedim, Llaushë dhe në qytet, dhe të gjithë jemi dëshmitarë se janë ndërtuar këto truare dhe është mirë se edhe në fshatin Pollatë është ndërtuar trotuari ose në dy anët tjera të Komunës tonë përfshirë Dyzin apo Llapashticën, mirëpo aty ku është arterja kryesore të mos ketë trotuar nuk më duket në rregull për arsye se vij nga ai lokalitet dhe kam kërkesa nga banorët e atij lokaliteti. Ky projektbuxhet është i ndryshëm prej të tjerëve sepse ka qasje të ndryshme programore prej subjektit tjetër programor dhe kritika e parë ka qenë që atë moment që ne do të vijmë në pushtet do të largohemi prej projekteve të asfaltit e të rrjetit të kanalizimit e që besa vendin më meritë për pjesën kryesore të investimeve prapë ishin ato.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, sot gjendemi këtu të thirrur në një seancë të jashtëzakonshme për votimin e dokumentit më të rëndësishëm që kalon përmes këtij Kuvendi. Këtij projektbuxheti nuk i duhet shumë analizë e thellë për të vërejtur se sa i mangët është, këtë e kemi diskutuar edhe në mandatin e kaluar kur e sollët në Kuvend, është një kopje e dokumentit të kaluar thuajse pa asnjë ndryshim. Shuma e parashikuar për vitin 2022 është 23,444,521.00€, te shpenzimet kapitale kemi një shumë prej 6,949,521.00€, në Drejtorinë e Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit ka një buxhet të ndarë prej 3,269,322.00€, që do të thotë 47% e investimeve kapitale orientohen në këtë Drejtori. Vetëm nëse ndalemi pak dhe i shikojmë projektet dhe emërtimet e tyre, lënë shumë për të dëshiruar, kemi një kod që na paraqitet te projektet prioritare asfaltimi i disa rrugëve dhe rrugicave nëpër disa lagje të qytetit dhe zgjerimi i tyre me një buxhet prej 300,000.00€ paramendojeni çfarë mbishkrimi, do të ishte arsyetuar disi një shumë rreth 20,000.00€ apo 30,000.00€ por jo edhe një shumë 300,000.00€. Për fshatrat nuk po diskutojmë fare sepse ka raste ku figuron, asfaltimi i disa rrugëve e që përfshin krejt përshtatjen e projekteve. Kjo po shihet ashiqare që mjetet janë të ndara për punimet që kanë ndodhur gjatë fushatës zgjedhore dhe asgjë tjetër. Pastaj, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Repë, Brecë, Shtedim, këtë ndërlidhje vetëm ju dini ta bëni.

Ndërtimi i hapësirave të reja në qytet me një shumë prej 250,000.00€, do të doja një përgjigje nga drejtori ku saktësisht parashihet ndërtimi i këtyre hapësirave, mandej në infrastrukturën publike kemi një buxhet të ndarë prej 1,815,000.00€ apo 26% e investimeve kapitale, dhe te infrastruktura publike gjithashtu kemi një specifikim skandaloz të projekteve ashtu siç kemi edhe tek zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve me një shumë 185,000.00€ dhe nuk ceken se cilët lumenj apo është projekt në vazhdimësi për rregullimin e shtratit të lumit Llap.

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit me një shumë prej 50,000.00€, qysh investoni në zgjerimin e rrjetit kur rrjeti aktual i ujësjellësit ka probleme të mëdha dhe e dimë se sa i nevojshëm është investimi në rrjetin kryesor për zgjedhjen e problemit me ujë të pijshëm, çka do të thotë se nuk keni strategji. Meremetimin e rrugëve me zhavor e kemi me një shumë buxhetore prej 250,000.00€, ku në vitin 2021 kjo shumë ishte vetëm 95,000.00€, me çfarë logjike e arsyetoni këtë kur jemi dëshmitarë se 90% e rrugëve nëpër fshatra dhe qytet janë të asfaltuara, kjo ka veç një emër, keqpërdorim asgjë tjetër apo është ndarje për punët e kryera më herët. Pastaj janë të ndara 400,000.00€ për rrugët me elemente betoni, ndërtimi i rrugëve me kubëza ndërtimi i kalesave të vogla në trotuare dhe i urave për këmbësorët në qytet dhe fshatra dhe atë pa kurrfarë specifikimi.

Te shëndetësia kam një pyetje, a keni ndarë ndonjë subvencion për Shoqatën “Handikos” nëse po atëherë sa është shuma. Në sektorin e bujqësisë pothuajse është një ndarje e njëjtë e projektbuxhetit të vitit 2021, por vetëm mungon subvencionimi i fermerëve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore që është një pjesë tepër e rëndësishme dhe mendoj se duhet të rritet shuma e subvencionimit dhe assesi të largohet ajo.

Në sektorin e arsimit kemi të ndarë një fond për shujtat e nxënësve prej klasës së I-rë deri në klasën e V-të, por mungon ndarja buxhetore për kontratën kolektive të arsimit që ka qenë edhe premtim gjatë fushatës elektorale, dua të them se le ta dinë sektori i arsimit se për vitin 2022 mos të presin asgjë për kontratën kolektive. Me gjithë këto mangësi ky buxhet nuk do të votohet nga ana jonë.

z.Arjant Topanica, theksoi, buxheti vjetor para së gjithash është një pasqyrim i asaj se si kjo qeverisje e projekton funksionimin e saj që me gjithë mangësitë dhe të metat e përmendura deri tani lënë shumë për të dëshiruar. Duke e ditur se ky buxhet vlen për të gjithë qytetarët pa dallim dhe është në funksion të tyre për secilin qytetarë është dashur që të merren sugjerimet dhe këshillat nga oponentët tjerë të sferës politike dhe nga partitë në opozitë, por nuk ka ndodhur një gjë e tillë dhe ky buxhet do të votohet sot nga pozita dhe është i hartuar sipas dëshirës dhe favoreve të saj.

Unë tani do të ngrisë disa shqetësime që mund të jenë edhe pyetje për të cilat presim përgjigje lidhur me këtë kornizë buxhetore. Së pari u përmend nga z.Qendrim Softolli largimi i subvencioneve për fermerët e dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi, po ndërlidhem këtu pasi që ne në tregun e Kosovës njihemi për bujqësi po ashtu edhe fshati Sfeçël nga vij unë është vend ku shumica e banorëve të këtij lokaliteti merren me bujqësi dhe pothuajse ky sektor është kryesor për ekonominë familjare me të cilat sigurohen të ardhurat familjare edhe për lokalitetin nga vijë unë por edhe për gjithë Komunën e Podujevës si trevë e Kosovës. Nuk e di dhe është e pa pranueshme për mua dhe për bujqit të hiqet ky subvencionim duke parë që vitet e fundit për fat të keq kemi pasur jashtëzakonisht dëme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, buxheti për subvencionimin e bujqve që ka qenë në vlerë 80,000.00€, të gjithë e dimë që këto dëme nuk janë të parashikuara dhe është problematikë që të kompensohen të gjitha këto dëme nga diçka që është e pa parashikuar, por të mos ndahet asnjë cent kjo i tregon bujkut llapjan se kjo qeverisje nuk është afër tyre dhe nuk mendon për ta në ditët më të vështira të tyre, në ditët të cilat ata presin bukën për djersën të cilën e kanë derdhur. Shqetësim tjetër është edhe ndërtimi i rrugëve, trotuareve, ndriçimi publik, urave e që nuk jam kundër ndërtimit të tyre aty ku janë parashikuar, por nga lokaliteti ku vijë unë për vitin 2022 nuk janë paraparë mjete buxhetore për ndërtimin e trotuareve dhe ndriçimit publik, në disa rrugë është bërë ndriçimi publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore e qëllimi i tyre dihet, por tani për vitin 2022 nuk është paraparë asnjë metër ndërtim i trotuarit, ndriçimit apo ndërtimin e një ure, sa jam në dijeni unë është projektuar një urë që të rikonstruktohet në fshatin Sfeçël ku në atë urë mund të kaloj vetëm një automjet dhe sa herë që shkaktohen të reshura atmosferike në atë pjesë nga lumi Dumnica shkaktohen vërshime.

Sa i përket sektorit të arsimit nuk kemi prioritetizimin e shkollës së fshatit Dumosh për vitin 2022, kur dihet se në atë shkollë nuk plotësohen kushtet minimale për zhvillimin e procesit mësimor, mandej shujtat për mësimdhënësit kanë qenë të premtuara edhe në takime me sindikatat dhe në premtimet elektorale, si dhe laboratorët jo funksionale që ju mungojnë kushtet teknike dhe mjetet furnizuese për funksionimin e tyre. Si përfundim uroj që punët e mira të realizohen dhe të lehtësohet jeta e qytetarëve llapjan sepse ai është qëllimi ynë i përbashkët dhe në këtë mënyrë do ta përmbyll fjalimin tim të parë duke i siguruar të gjithë qytetarët llapjan se ne do të jemi gardian të interesave të tyre në çdo seancë, në ç' do veprim, në ç' do buxhet gjatë mandatit tonë të kësaj qeverisje.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, te planifikimi për ndarjen e buxhetit për vitin 2022, në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit janë ndarë 49,950.00€ subvencione për kulturë dhe sport mirëpo nuk është përfshirë rinia, nuk e di a është ky një gabim teknik apo kjo qeverisje nuk ka paraparë subvencione për të rinjtë e Komunës së Podujevës, shpresoj që ky të jetë një gabim teknik por në qoftë se nuk është ju lutem na jepni një arsye përse nuk keni ndarë mjete buxhetore për të rinjtë e Komunës së Podujevës.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, pasi e shikove projektbuxhetin për vitin 2022 kam një pyetje për drejtorin e DBF-së, i nderuari drejtor z.Fatlum Osmani a mund të na tregoni se në çfarë baze apo kriteri keni vendosur që fshati Llapashticë si njëri ndër lokalitetet më të mëdha në Komunën e Podujevës të mos përfshihet në projektin e ndriçimit publik. Janë vendosur 30 llamba ndriçuese në kohën e fushatës zgjedhore në një segment shumë të shkurtër dhe është çudi shumë e madhe përse është ndaluar projekti në gjysmë. Ju e dini se ndriçimi publik është i një rëndësie të veçantë sepse kam shumë bashkëvendës që punojnë furra buke dhe udhetojnë në këmbë dhe u rrezikohet jeta e tyre nga qenët endacak dhe nga lëvizja e automjeteve në atë pjesë të rrugës.

Unë i përkas opozitës dhe ndoshta nuk do ta merrni me rëndësi fjalën time, por a është e nderhme nga ajo që këtu e keni një përfaqësues në subjektin tuaj nga fshati Llapashticë që ju ka sjellë mbi 500 vota dhe ju e keni lënë fshatin e tij në errësirë. Shtrirja e ndriçimit publik është bërë në lokalitete më të vogla se në fshatrat Llapashticë e Poshtme dhe Llapashticë e Epërme, po e marrë shembull një pjesë të rrugës prej restorantit “Artela” deri në fshatin Obrançë që është rregulluar ndriçimi publik mirëpo në atë pjesë të asaj rruge nuk ka asnjë shtëpi të banimit dhe si e tillë nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë. Bashkëvendësit e mi nga Llapashtica le ta dinë se ju është bërë një padrejtësi shumë e madhe, shpresoj se do të reflektoni, shpresoj që për këtë çështje nuk do të pres një përgjigje nga dy drejtorët se do të shikojmë vitin tjetër për këto proejkte.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, njëri nga kolegët e partisë në pushtet tha se i është dhënë prioritet fushave në të cilat në të kaluarën nuk është bërë asgjë, ndërsa për sektorin e arsimit është ndarë një shumë e konsiderueshme për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, atëherë a mund të na thoni se nëse nuk ka infrastrukturë dhe nuk është bërë asgjë çka do të përmirësoni nga infrastruktura shkollore.

znj.Arjeta Abazi, theksoi, pa dyshim projektbuxheti është një ndër dokumentet më të rëndësishme të Komunës së Podujevës, nga ky projektbuxhet që u prezantua sot para nesh nga ana e Ekzekutivit shihet qartë se edhe këtë vit qasja e Ekzekutivit lë për të dëshiruar pothuajse në secilën fushë që trajtohet nga ky buxhet. Në bazë, buxheti në vete do të duhej të siguronte zhvillim ekonomik dhe mirëqenie për qytetarët duke ofruar trajtim meritore për fushat që sigurojnë këtë e të cilat sipas asaj që shihen në këtë projektbuxhet sërish edhe pse kritikohet dikur prioritet vazhdon të mbetet asfalti por si do që të jetë unë do të ndalem në fushën e arsimit, specifikisht kam disa kërkesa.

Në projektbuxhetin e viti 2022 të futet ndërtimi i një shkolle fillore në qytet pasi që nevoja për këtë shkollë është shumë e madhe, ne kemi shkollën “Naim Frashëri” e cila punon në 3 ndërrime që është problem për fëmijët prindërit dhe mësimdhënësit. Ndërtimi i kësaj shkolle do të zgjidhte problemin e klasave të mbingarkuara me nga 35 deri në 40 nxënës në një klasë e që vështirëson shumë mësimdhënien dhe mësim nxënien. Një kërkesë tjetër kam që të përfshihet mbulueshmëria e obligimeve që dalin nga kontrata kolektive e arsimit ashtu siç e cekën edhe parafolësit e mi pasi që realizimi i saj është obligim ligjor dhe në këtë formë Komuna do të kursente para nga proceset gjyqësore dhe mësimdhënësit nuk do të kishin nevojë të vraponin nëpër Gjykata pa fajin e tyre.

Sot gjithashtu kërkojmë angazhim edhe të çështja e bursave për nxënës dhe student, të shikohet çdo mundësi për rritje të buxhetit dhe të rishikohen kriteret e mos të paraqiten problemet e shkaktuara sikurse vitin e kaluar.

Një problem tjetër që e hasim ç’do ditë është parkimi i veturave të prindërve që i sjellin fëmijët e tyre në shkollat “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri”, andaj kërkoj nga ana juaj që të planifikohet një parking për prindërit që i sjellin dhe i marrin fëmijët e tyre në shkollë, e që ndërtimi i një parkingu në këto hapësira do ta zgjidhte problemin e bllokimit të asaj rruge dhe do ta zvogëlonte rrezikun që u kanoset fëmijëve dhe prindërve sa herë vijnë dhe dalin nga shkolla, e që një

bashkëpunim në mes të Drejtorive përkatëse ky është një problem që zgjidhet me një buxhet të vogël por duhet pasur vullnetin për ta zgjidhur.

Kërkesë tjetër kam për ndarjen e buxhetit për trajnimin e mësimdhënësve, trajnimet janë shumë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies por janë edhe kusht ligjor për vazhdimin e licencave të mësimdhënësve.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, me vëmendje i dëgjova të gjitha diskutimet e bëra, është pozita që po e lavdëron këtë projektbuxhet me arsyetimin se është më i miri në këto 22 vitet e fundit dhe në anën tjetër është opozita që i ka kritikën e saj por të gjithë pothuajse e kanë një emërues të përbashkët se ky projektbuxhet është dokumenti më i rëndësishëm i Komunës dhe si të tillë unë personalisht do ta mbështes dhe me gjithë vërejtjet sepse një gjë të tillë besoj se qytetarët nuk e meritojnë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nuk dua të replikoj me askënd, por i drejtohem këshilltarit z.Naim Çunaku se Rregullorja e Punës së Kuvendit është miratuar në vitin 2009 dhe ka kaluar shumë kohë kur materialet për thirrjen e Kuvendit na janë dërguar në formë fizike prej asaj kohe kur kam qenë pjesë e asamblesë Komunale, kështu që teknologjia ka ecë dhe nuk kemi arsye të ankohemi për atë.

z.Naim Çunaku, theksoi, një Rregullore e vjetër apo e re nuk cilësohet në bazë të kohës por ajo Rregullore deri sa është në fuqi dhe përderisa nuk është nxjerrë Rregullore tjetër nuk e ka rëndësinë se a është e vitit 2010 apo vitit 2018, kjo për njohurin tuaj zotëri Kryesues. Se ku ka përparuar teknologjia zotëri Kryesues edhe unë jam pjesë e kësaj bote dhe në kohën tuaj kur ke qenë këshilltar ka qenë një ndër propozimet e Grupit tonë bashkërisht që ta tejkalojmë këtë fazë, e kjo ka qenë në vitin 2009 dhe për herë të parë në vitin 2013, me një vendim të Kuvendit janë pajisur këshilltarët e Kuvendit me laptop dhe posa kemi filluar mandatin hapi i parë që kemi kaluar është se jemi pajisur me laptop dhe këta laptop janë pjesë e teknologjisë së viti 2013, çfarë ka ndodhë tutje nuk e di mirëpo ajo ka qenë vetëm dakordancë. Ligji nuk lejon pleqni dhe as praktika, ligji përderisa është në fuqi ose respektohet ose ndryshohet zotëri Kryesues, unë thash edhe diçka tjetër prej momentit kur jeni zgjedhur Kryesues i Kuvendit, e kam thënë edhe dje në mbledhjen e KPF-së dhe po e përsërisë edhe sot, ti duhet ta kuptosh rolin tënd se je njëri nga anëtarët e barabartë të këtij Kuvendi dhe roli juaj primar është që t'u krijosh kushte primare kolegëve tuaj në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës sepse nuk mund të veprojnë në mënyra të ndryshme administrata dhe Kuvendi, vetëm atëherë kur administrata dhe Kuvendi e mbështesin njëra tjetrën e arrijmë suksesin dhe personalisht e them se më tepër se gjysma e anëtarëve të Kuvendit nuk janë pajisur me pajisjet në fjalë, edhe pse nuk desha të flasë në emër të anëtarëve tjerë por vetëm në emrin tim.

Unë e kam një telefon dhe nuk mundem që përmes telefoni të përgatitem dhe të marrë pjesë në projektbuxhet, dikush mund të thotë se ju kemi thënë pas tri dite ejani merrni materialet, kuptojeni se Kuvendi është organi më i lartë i Komunës dhe nuk mund të na shndërroj në postier askush.

z.Bahri Selimi, theksoi, po ndërlidhem me atë që e tha parafolësi im, është e vërtetë se prej vitit 2013 asamblistët pajisen me laptop në mënyrë që t'ju lehtësohet qasja në dokumente dërgimi i materialeve në formë fizike, e din shumë mirë i nderuar parafolës se prej asaj kohe kur së bashku ishin pjesë e asamblesë komunale ajo formë e dërgimit të materialeve nuk është praktikuar më. Asamblistët gjithëherë janë pajisur me laptop edhe këtë radhë i them z.Naim Çunakut dhe gjithë të tjerëve se do të pajisen me laptop sepse është domosdoshmëri kjo procedurë dhe jemi në pritje që të kthehen laptopët të cilët i kanë pasur asamblistët e legjislaturës së kaluar e që tani nuk e kanë fituar edhe njëherë këtë mandat, andaj laptopët janë dhënë në shfrytëzim dhe pas përfundimit të mandatit këta laptop do të kthehen, kurse pas kthimit të të gjithë laptopëve nga ana e këshilltarëve që nuk janë pjesë e kësaj legjislature do të riformatohen, do të rregullohen dhe do t'ju shpërndahen të gjithë

asamblistëve, përjashtimisht atyre që kanë qenë pjesë e mandatit të kaluar dhe janë pjesë e këtij mandati të ri të Kuvendit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetari i Komunës, i drejtohet këshilltarit z.Naim Çunaku të mos brengoset për çështjen e pajisjes me laptop sepse kjo do të rregullohet, fundja nëse është shumë e rëndësishme mund të ta jap laptopin tim.

z.Naim Çunaku, theksoi, shqip po flasim dhe shumë mirë po kuptohemi, nuk e kam problemin personal unë, kemi disa akte normative këtu që e rregullojnë këtë çështje, e thash shumë mirë që kemi pasur një dakordancë për ta tejkaluar atë çështje, mirëpo poenta qëndron këtu se në këtë mbledhje të jashtëzakonshme që unë dhe shumë të tjerë jemi këtu për të debatuar nuk merremi me çështjen tjetër a i kanë kthyer ose jo laptopët. Poenta është se nuk e kam pasur materialin e mbledhjes dhe as teknologjinë. Unë e di se kjo çështje do të rregullohet se në fund për këtë çështje ne marrim vendim sepse edhe në të kaluarën ne kemi marrë vendime.

Nga ajo që mu ofrua nga Kryetari i Komunës, unë nga kjo replikë që patëm, prej kësaj salle do të shkojë në zyrën e Kryetarit që ta marrë laptopin sepse publikisht e tha këtë.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, ju falënderoj të gjithëve për diskutimet rreth këtij propozim buxheti ku të gjithë po pajtohemi se është dokumenti më i rëndësishëm i vitit të cilin e miraton asambleja komunale. Do të ndalem te disa vërejtje apo propozime që u bënë më parë nga asamblistët e nderuar, sa i përket çështjes së ndarjes së buxhetit për zyrën e Kuvendit normalisht që është e ndarë vetëm kategoria e pagave kurse për kategoritë e mallrave, vlen të ceket se në të kaluarën ka qenë një praktikë ku për të gjitha Drejtoritë është ndarë buxhet qoftë për furnizim për zyrë, qoftë për materiale didaktike ose të ndryshme, mirëpo besojmë se ajo ka shkaktuar disa probleme në funksionalitetin e çështjeve, dhe është marrë si vendim që të gjitha mjetet të ndahen në Drejtorinë e Administratës e cila do të kujdeset qoftë për furnizim me Laptop, qoftë për furnizime tjera të cilat i takojnë Kuvendit të Komunës si dhe për shpenzime tjera.

Lidhur me kritikën që ka qenë edhe në të kaluarën rreth specifikimit të çështjeve të buxhetit, e kam sqaruar edhe atëherë dhe më duhet ta përsërisë sërish sqarimin, çështja është se këto tabela që i kemi në këtë dokument normalisht janë të punuara si tabela në programin Exel, program ky i cili lejon që të shkruhet tekst i mjaftueshëm, mirëpo në programin e investimeve publike të cilin e menaxhon Ministria e Financave, maksimumi i karaktereve që lejohen të shkruhen janë 40 karaktere, dhe ta zëm nëse flasim për ndërtimin e rrugëve në qytet, çështje për të cilën foli këshilltari z.Qëndrim Softolli duke thënë se nuk janë të specifikuara, sqaroj se me këtë projekt të planifikuar buxhetor ndoshta do të jenë 20 rrugë që do të ketë intervenime me këtë kod buxhetor dhe teknikisht është e pamundshme që në projektbuxhet të bëhet ai specifikim i të gjitha këtyre rrugëve ku do të investohet dhe normalisht si emërtim jepet kështu dhe normalisht në sqarimet tjera që i bëjmë specifikohen kur të dërgohen për aprovim në Ministrinë e Financave, e njëjta logjikë vlen edhe për projektet tjera të planifikuara siç janë planifikimet për punë me zhavorr ku do të ndërtohen qindra rrugë me këtë pozicion buxhetor dhe atë jo rrugë fiktive siç e ceku këshilltari i cekur duke thënë se janë shtruar në fushatë për zgjedhje dhe duhet të paguhen tani, kjo nuk qëndron sepse të gjitha pagesat janë kryer dhe për këtë ka persona këtu që mund t'ju japin informata.

Pati shumë propozime që ndoshta të gjitha mund të jenë të arsyeshme por një gjë duhet ta kupton secili që buxheti i Komunës së Podujevës është vetëm 23,449,521.00€, prej tyre vetëm 6,949,521.00€ janë për investime kapitale.

Pati edhe propozime tjera për çështjen e subvencioneve, çështje për të cilën kemi një rritje të ndjeshme që ka ardh me insistimin e vet neve duke bërë presion të vazhdueshëm në Ministrinë e Financave që të rritet limiti në kategorinë e subvencioneve dhe nga 760,000.00€ që ka qenë në vitin e kaluar tani kemi afër 960,000.00€, mandej kemi rritje në kategorinë e subvencioneve në pjesën

dërmuese të Drejtorive duke filluar prej Drejtorisë së Arsimit ku kemi dyfishim të buxhetit për subvencione, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi po ashtu dyfishim të fondit për subvencione, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik nuk mund të themi se ka dyfishim të buxhetit sepse nuk ka pasur asnjëherë buxhet, por që tani kemi afër 140,000.00€ subvencione, si dhe kemi një rritje të ndjeshme në fushën e bujqësisë dhe kjo rritje, meqë pati kritikë për buxhetin që ka qenë për kompensimin e dëmeve në bujqësi që kanë qenë rreth 76,000.00€, këtë vit nuk specifikohet kjo mirëpo si tërësi kategoria e subvencioneve në bujqësi nuk është zvogëluar por është rritë dhe normalisht në bazë të prioritetëve që parashihen nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe që e konsideron të nevojshme që gjatë vitit në rast se eventualisht ka dëme në bujqësi (dhashtë Zoti të mos ketë), të kompensohen dëmet nga fondi që ka kjo Drejtoria, mirëpo në këtë aspekt ne padyshim jemi edhe dëshmitar dhe të informuar që është duke u përgatitur një reformë nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me këtë çështje ku me siguri që do të bëhet skemë nga sigurimet për të cilën ne sigurisht të gjithë pajtohemi se e vetmja rrugë për të zgjidhur problemin e dëmeve në bujqësi është sistemi i sigurimeve e që Ministria në fjalë ka filluar për disa kategori ta bëjë subvencionimin e primave të sigurimeve që besoj se është rruga më e mirë për ta zgjidhur këtë problematikë.

Pati edhe disa propozime në fushën e arsimit e që mendoj se çka do që propozon dikush në fushën e arsimit asgjë nuk gabon sepse arsimi definitivisht duhet të jetë prioritet dhe është prioritet tani në Komunën e Podujevës sepse si qeverisje e kemi prioritetizuar këtë fushë ku kemi planifikuar afër pesëfishim të fondeve në fushën e renovimeve të institucioneve arsimore ngase ne jemi në dijeni për problemet e shkollave ku një pjesë e madhe e tyre kanë probleme të ndryshme qoftë me dritare, qoftë në dysheme, rrethoja, oborre, terrene sportive etj, dhe në të gjitha këto pothuajse në të gjitha institucionet arsimore do të investohet me këtë fond sepse lejohet kjo rritje e madhe buxhetore.

Këtu ka edhe përvoja të mëhershme në fushën e asamblesë komunale dhe po të marrim gjitha buxhetet e mëparshme në fushën e arsimit gjithë buxheti ka qenë afër 100,000.00€ për investime në fushën e institucioneve arsimore, pse është bërë, sepse atëherë ka qenë limiti buxhetor i përcaktuar me Qarkore të Ministrisë së Financave, përndryshe do të zbriste ende më poshtë buxheti për investime në fushën e arsimit, ndërse ne pavarësisht që me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë është paraparë limiti buxhetor në shumë 119,000.00€ në këtë fushë, kemi shkuar me ndarjen e buxhetit në katërfishim sepse e kemi të drejtën ligjore nga granditë e përgjithshme dhe nga të hyrat vetanake t'i bartim në arsim dhe këtë gjë e kemi bërë.

Tek çështja e subvencioneve në kulturë rini dhe sport, kjo normalisht që është buxhet në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në shumë rreth 960,000.00€ e që normalisht vlejnë për këta sektor, andaj nuk bëhet fjalë për ndonjë gabim teknik siç u tha, as asgjë të tillë por këto mjete vlejnë për gjithë sektorët dhe kjo shumë e ndarë është limiti i mjeteve që ne si Komunë në bazë të Qarkores Buxhetore mund t'i ndajmë për kulturë rini dhe sport e që kemi bërë përpjekje maksimale që mjetet buxhetore ti ndajmë në mënyrë proporcionale për të gjitha kategoritë.

Kështu që mendoj se kemi bërë më të mirën e mundshme dhe kemi qenë bashkëpunues me të gjithë për këtë projektbuxhet i cili në fakt është hartuar në mandatin e kaluar por që nuk është miratuar në atë kohë dhe tani është e domosdoshme të miratohet në këtë mandat nga ky Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, Kuvendi i Komunës e ka linjën e vet buxhetore, në fakt do të duhej ta ketë linjën e vet buxhetore. Çështja tjetër, a mendojmë ne që si Kuvend në një të ardhme të afërt duhet ta komplotojmë Kuvendin me Komitete Konsultative që janë ndihmesë edhe për Kuvendin por edhe për administratën. Krejt ajo që më bëri të marrë fjalën është se është shumë buxhetore e njëjtë dhe identike sikurse për vitin 2022 ashtu edhe për vitet 2023 dhe 2024, do të thotë asgjë nuk parashihet që do të ketë lëvizje edhe pse e di që ato janë vetëm parashikime dhe do të mund të ketë lëvizje qoftë

me rishikim të buxhetit qoftë me vendime tjera, por momentalisht ne jemi në fillim të punës së Kuvendit të Komunës dhe si Kuvend ka nevojë edhe për komisione dhe komitete tjera e që sigurisht është dashtë ta ketë linjën e vet buxhetore.

E përmenda edhe më herët që jo vetëm Drejtoria e Administratës por e gjithë administrata shëf i së cilës është Kryetari i Komunës, dhe ne si Kuvend që jemi si organi më i lartë i Komunës, unë kurrë nuk e thash me asnjë fjalë që ne nuk duhet të gjejmë dhe harmonizojmë gjuhë të përbashkët për një qeverisje të suksesshme për qytetarin, jo për të tjera gjëra, fundja ne kemi pas një garë zgjedhore, kemi pas programe zgjedhore dhe tani për 4 vitet e ardhshme jemi të drejtuar për të lehtësuar jetën e qytetarit. Drejtori i Drejtorisë së Administratës nuk i jep llogari Kuvendit por shëf e ka Kryetarin e Komunës.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, në fakt atë që e potencova më herët rreth ndarjes së buxhetit për rini, ende po mendoj se është gabim teknik i nderuar drejtor i DBF për arsye se në projekt buxhet nuk e keni shkruar fjalën rini, dhe ka një arsye përse Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit quhet ashtu. Përndryshe në qoftë se nuk qenka gabim teknik siç e potencoj drejtori i DBF, atëherë duhet të na tregoni sa prej këtyre mjeteve buxhetore të ndara do të shkojnë specifikisht për Kulturë, sa për Rini dhe sa për Sport.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, unë e di sakt çka nënkupton përmirësimi i infrastrukturës shkollore, por këtu u tha se asgjë nuk është bërë në të kaluarën kurse tani po i jepet prioritet, mirëpo sa për rikujtimin e juaj Kryetari aktual i Komunës për 8 vite ka qenë drejtor i Drejtorisë së Arsimit, andaj i nderuar drejtor i DBF a mund të na tregoni saktësisht për ato mjetet që i ceke sepse nuk është e përfshirë një gjë e tillë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, dëgjova me vëmendje të gjitha shqetësimet, kërkesat dhe nevojat e paraqitura, mirëpo ne duhet të kemi parasysh që limitet buxhetore për këtë vit janë faktikisht këto që edhe janë planifikuar. Gjithmonë në planifikime edhe mund të ketë ndonjë lëshim dhe gjatë fazës së punë shpesh janë bërë ndryshime dhe falë Zotit ky buxhet nuk është statik dhe gjithmonë ka mundësi që brendapërbrenda punëve të ndryshme të ketë paksa fleksibilitet.

Aty ku mendojmë se ka mangësi, sigurisht që ne si Ekzekutiv i Komunës jemi të gatshëm që gjatë procesit të mënjanojmë ato lëshime që mund të jenë.

Është mirë që ka kërkesa por nuk është mirë dhe nuk më pëlqen forma lokaliste sepse nuk jeni asambleist të një lokaliteti por jeni asambleist të qytetarëve të Komunës së Podujevës, dhe ne ose ju secili lëshohemi në lokalizma atëherë ne dështojmë në planifikim.

Jeni në dijeni se një pjesë e madhe e juaja, bashkë me mua por edhe të tjerët, kemi dhënë shumë vërejtje gjatë këtyre viteve që buxheti i Komunës po lokalizohet në një hapësirë të caktuar dhe pjesë të mëdha të territorit të Llapit po mbesin jashtë punëve të cilat janë të nevojshme të kryhen.

Sigurisht që ne e kemi qeverisjen 4 vjeçare, këtë vit e fillojmë me këto projekte, vitin e ardhshëm besojmë që do t'iu radha lokaliteteve tjera, por një gjë duhet ta keni parasysh që ne si qeverisje 1 vjeçare në vitin e kaluar nuk kemi punuar natën, nuk kemi asfaltuar natën, nuk kemi shtruar trotuare natën, nuk kemi shtrirë ndriçimin publik natën, dhe këtë ju e dini shumë mirë, pastaj nuk kemi punuar ditën e zgjedhjeve dhe nuk kemi punuar të diela, andaj ju e dini kush i ka bërë këto punë në të kaluarën dhe nuk është mirë për punët e juaja të këqija që dikur i keni bërë, tani të na akuzoni neve sepse nuk i kemi bërë ne, mandej nuk kemi hyrë në borxhe, asnjë borxh nuk e kemi dhe ato punë që janë kryer edhe janë paguar.

Na vije keq që një pjesë e buxhetit nuk ka mund të shpenzohet për ta sjellë maksimalisht zero zero shpenzimin e buxhetit në vitin 2021, por nuk i kemi lënë nga 2 milion euro suficit, dhe kjo është bërë falë një pune dhe angazhimi të mirë të Ekzekutivit të Komunës.

Po ashtu dëgjova edhe një varg vërejtjesh që u bënë ku njëra ndër to ishte për problematikën e ujësjellësit, po është e vërtetë se ka probleme me ujësjellësin mirëpo nëse keni pritur që brenda 1 vitit qeverisja e re do ta zgjidh problemin 20 vjeçar që nuk është zgjidh nga ju, besoj që është gabim sepse nuk zgjidhet çështja e ujësjellësit për një vit, madje vetëm një parallogari e koston është rreth 2 milion euro andaj jeni në dijeni se si Komunë nuk kemi mundësi buxhetore të ndajmë 2 milion euro për ujësjellës, por zgjerimin e shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit domosdoshmërisht duhet ta bëjmë edhe pse nuk është ekskluzivisht detyrë e Komunës por është Njësia menaxhuese e ujësjellësit qendrorë – Kompanisë përkatëse, ndërsa Komuna ndihmon në zgjerimin e shtrirjes së rrjetit por a do të thotë kjo që ne nuk duhet të interesohemi, sigurisht që jo sepse fundja është prej prioriteteve të para që duhet të bëhet ngase janë nevojat e qytetarëve, dhe viti që lam pas ka qenë një vit goxha me probleme në këtë aspekt, qoftë objektive apo subjektive andaj edhe besoj se ne duhet të punojmë në këtë drejtim.

Çështja tjetër që u cek dhe që ka të bëjë me rinin, ne do të investojmë në rini por jo me ato investime çfarë ju i keni bërë (projekte për dajë, nipa, teze etj.), nuk do të ketë më investime dhe projekte të tilla, do të investohet vërtetë për rini, por jo për farefis dhe OJQ fiktive ashtu siç është bërë deri tani, andaj ne kemi për obligim që këtë buxhet ta menaxhojmë ashtu siç duhet dhe çdo gjë do të jetë transparente, jo në formën çfarë është menaxhuar deri tani, dhe mos harroni të nderuar (me theks disa asambleist që janë edhe më herët këtu), që nuk është kohë e largët që buxheti për kulturë në të kaluarën ka qenë 5,000.00€ dhe këtë e dini shumë mirë, megjithatë ne me këto mundësi buxhetore që kemi, e kemi rritë buxhetin për kulturë rini dhe sport, mirëpo do të isha shumë i kënaqur po të ndanim ndoshta një shumë buxhetore 200,000.00€ dhe ka nevojë të tillë të jeni shumë të bindur sepse kanë nevojë klubet sportive, kanë nevojë institucionet rinore, kanë nevoja aktivitetet kulturore, por mundësit për ndarje të buxhetit për këta sektor janë këto që janë, mirëpo po punojmë dhe po angazhohemi bashkërisht që të mund ta rrisim këtë ndarje buxhetore, gjë e cila bëhet duke i rritur të hyrat vetanake, por ju e dini shumë mirë se të hyrat vetanake nuk rriten në formën qysh ju keni menaxhuar deri tani dhe këtë mund ta shikoni se sa kompani të forta (mëdha) nuk kanë qenë fare të përfshira në të hyrat vetanake të Komunës dhe për këtë pastaj mund të analizoni formën dhe mënyrën qysh janë bërë, kurse ne vitin që lam pas e kemi aktivizuar bukur shumë aktivitetin e të hyrave vetanake dhe kemi rritur bukur shumë sepse duke rritur të hyrat vetanake do të krijohen mundësitë e financimit të projekteve të ndryshme për të mirë të qytetarëve të Komunës së Podujevës. U përmend nga një prej parafolësve që pjesë të caktuara të territorit të Komunës së Podujevës (në veri, në jug, etj) kanë mbet pa përfshirë në planifikimet buxhetore për investime, unë e them se për aq sa kemi mundësi nuk jemi të interesuar të krijojmë paralizëm por jemi të interesuar të shkojmë sipas prioriteteve që paraqiten si prioritete, të veprojmë më herët kurse ato të tjerat për të cilat mund të pritët, t'i realizojmë pak më vonë.

Është mirë që të paktën në këtë çështje të buxhetit të jemi bashkë, nuk është mirë që ky buxhet ka mbet deri tani pa u miratuar e që në kushte normale jeni në dijeni se kur ka qenë koha për tu miratuar, dhe është i njëjti buxhet që ka qenë në atë kohë, por keni dashtë ta dëmtoni paksa procesin, keni dashtë të bëni politikë, mirëpo ne po diskutojmë për interesa të qytetarëve dhe kur është në pyetje qytetari nuk është mirë të bëhen gjëra të tilla por është mirë që vërtetë të mbrohet dhe të ruhet interesi i tyre dhe të shtyhen projektet përpara.

Ky projektbuxhet sigurisht se nuk është më miri i mundshëm, por besoj se është më i avancuar n'raport me buxhetet tjera të kaluara, përsosmëri asnjëherë nuk ka dhe vend për kritika gjithëherë do të ketë, mirëpo ejani të ulemi bashkë dhe të bashkëpunojmë, dhe ashtu siç ju kam ftuar më herët ashtu edhe në të ardhmen do t'ju ftoj të bashkëpunojmë dhe kjo nuk paraqet kurrfarë problemi, por nuk është mirë pastaj të thonë që NN lokalitetin e keni lënë pa investime, në NN lokalitetin keni planifikuar investime e gjëra të tilla, prandaj ju them ejani urdhëroni bëhuni pjesë e procesit edhe pse

jemi opozitë ngase pa opozitë nuk bënë, por ejani bëhuni pjesë e proceseve të mëdha dhe ne jemi të gatshëm t'iu dëgjojmë, t'i marrim parasysh rekomandimet e juaja, (natyrisht ato që janë të mira, të arsyeshme dhe në interes të qytetarëve), por jo rekomandime dhe kërkesa personale e individuale.

Mandej u përmend çështja e shkollave fillore, jemi në dijeni se në këto shkolla ka vite që nuk janë bërë investime në zgjerimin e infrastrukturës shkollore, ne planifikojmë që shkolla e mesme ekonomike të shndërrohet në shkollë fillore me kushtin që ta ndërtojmë një rrjetë të ri të shkollës së mesme ekonomike të kompleksi i shkollave të mesme, pra ta zhvendosim komplet në një lokacion kompleksin e shkollave të mesme të larta, kurse këtë aktuale që është shkolla ekonomike ta kthejmë në shkollë fillore të mesme të ulët, kjo për arsye se ashtu siç jemi në dijeni se kushtet në shkollat e qytetit nuk janë të mira, ka stërngarkesë e cila vazhdon edhe më tutje sepse gjithherë kemi ardhje të nxënësve, përdërisa fshatrat zbrazen qyteti mbushet, andaj ne duhet të kemi planifikime në këtë aspekt e që besoj se këto gjëra me kohë do t'i rregullojmë.

Është bërë zhurmë e madhe mediatike dhe elektorale duke thënë se është lënë pa hyrë në planifikime shkolla e fshatit Obrangjë, pastaj po ashtu edhe për shkollën e fshatit Dumosh duke thënë se nuk po bëhen, po dërgohen në fshatin Llugë e gjëra të tilla, mirëpo tani sigurisht po e vëreni se është heq edhe ndërtimi i shkollës në fshatin Llugë kurse është planifikuar për fshatin Obrangj, prandaj nuk qëndrojnë ato që janë thënë nga ana juaj. Edhe për shkollën e fshatit Dumosh jemi në dijeni se është në gjendje jo të mirë e që nuk është vetëm që 1 vit por është që 10 vite ashtu ndoshta, shkollë e cila është meremetuar pasluftës por ashtu siç është sot nuk i plotëson kushtet, prandaj po punojmë dhe do të punojmë duke pas parasysh se e kemi edhe Qeverinë qendrore e cila duhet të investoj dhe është e gatshme të investoj e që konsideroj se do ta mbajmë një bashkëpunim të mirë me nivelin qendrorë në mënyrë që projektet të cilat ne nuk kemi mundësi të realizojmë si Komunë, bashkërisht me nivelin qendrorë t'i realizojmë dhe krejt kjo në interes të qytetarëve.

Për fund edhe njëherë ju falënderoj shumë për të gjitha ato vërejtje dhe sugjerime serioze, reale dhe të arsyeshme që ishin (jo ato që ishin tendencioze), ngase është mirë t'i dimë dhe natyrisht ndihmohemi ne si Ekzekutiv në mënyrë që t'i mënjanojmë në rast se janë bërë lëshime të tilla.

z.Arjant Topanica, theksoi, sa i përket asaj që u përmend lokalizmi, ne ë gjithë e dimë se nuk jemi asambleist të një lokaliteti të caktuar por jemi asambleist të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe ashtu do të jemi deri në fund, mirëpo edhe e dimë dhe është e logjikshme që t'i njohim më mirë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve nga lokalitetet nga vijmë. Unë nuk kërkoja të hiqet ndonjë projekt nga lokalitetet tjera por vetëm kërkoja një gjë të arsyeshme, të nevojshme dhe me prioritet për lokalitetin prej nga vie unë.

Sa i përket asaj se si është punuar gjatë fushatës zgjedhore dhe cilave ditë është punuar këtë më së miri e dinë qytetarët nga fushata e fundit zgjedhore, ndërsa sa i përket asaj që vazhdimisht po përmendet, (Ju Ju, 20 vite, gjendje e re e të ngjashme), të gjithë e dimë se ku ishim ne si asambleist gjatë këtyre viteve dhe ku ishin të tjerët.

Sa i përket thirrjes për bashkëpunim, thirrjet e tilla ditën e votimit nuk bëhen, ka qenë koha kur do të duhej të bëhej thirrje të tillë e që është dashtë të bëhet gjatë procesit të hartimit të këtij projektbuxheti dhe projektsioneve prioritare buxhetore.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, drejtori i DBF nonstop po e arsyeton mos specifikimin e projekteve duke e lidhë me limitin e karaktereve që lejohet brenda një kolone dhe unë po e kuptoj atë por nuk besoj që ka limit për krijimin e një kolone të re dhe specifikimin adekuat për një projekt. Këtë e them duke u bazuar edhe në projektbuxhetet e kaluara ku kemi shembuj ku janë specifikuar të paktën për secilin projekt dhe secilin fshat, ndoshta jo me emër të rrugës, për fshat dhe projekt po.

Sa i përket shtrirjes së re të ujësjellësit, ndarja e vetëm 50,000.00€ tregon qasje jo serioze duke ditë gjendjen me furnizim që ekziston tani e që ka probleme dhe që aktualisht ka probleme me furnizim,

ndërsa sa i përket asfaltimit të rrugëve natën, beso qejfi mu bë që u përmend kjo ngase 24 orë punonte Komuna dhe mendoja se nëse vazhdon kështu shumë shpejt ndoshta brenda 6 muajve do të përfundojnë të gjitha projektet, kurse tani mbas zgjedhjeve kemi krejt qasje tjetër.

Përgjigje nuk mora nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që ka të bëjë me ndarjen e një fondi për Shoqatën “Handikos”.

Sa i përket përgjegjësisë për gjendjen në shkollë, e dim që Kryetari aktual i Komunës ka qenë pjesë e ekzekutivit të komunës në të kaluarën dhe një pjesë e përgjegjësisë i takon edhe këtij.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, pyetjet nga ana e këshilltarëve mund të bëhen edhe me shkrim dhe po ashtu edhe përgjigjet mund të kthehen me shkrim nga ana e Ekzekutivit.

z.Driton Veliu, U.D. drejtor i DSHMS, theksoi, sa i përket pyetjes rreth planifikimeve të ndara për Shoqatën “Handikos”, për vitin 2022 kemi planifikuar t’i ndajmë 12,000.00€.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, i nderuar Kryetar i Komunës, as unë nuk e pash të arsyeshme që në fjalimin tim të parë në këtë Kuvend të flasë për lokalitetin prej nga vie sepse nuk i takoj vetëm fshatit Llapashticë dhe se vetëm në Llapashticë nuk kam marrë vota, do të thotë nuk e përfaqësoj vetëm këtë fshat, mirëpo kur e kam shikuar projektbuxhetin nuk e pash fare këtë fshat, andaj vetëm këtë pyetje e kam, a mendoni se është e drejtë të lihen projektet në gjysmë (fjala është për ndriçimin publik)

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, investimet në fshatin Llapashticë nuk do të mbeten në gjysmë duke përfshirë edhe ato projekte që ka filluar. Janë bërë edhe 3 apo 4 loto të ndriçimit publik që janë tenderuar dhe janë kryer por që janë arkivuar dhe ankesat kanë mbet në Organin e Shqyrtues të Prokurimit – OSHP, prandaj çdo gjë që është planifikuar do të realizohet sepse ne nuk premtojmë kot por ato që i premtojmë edhe i realizojmë dhe ju e dini këtë, por të presim kur ti vie koha sepse tani në dimër nuk mund të punohet, prandaj edhe atë projekt të fshatit Llapashticë do ta përfundojmë dhe ti (i drejtohet parafolësit) do t’vish ta presh shiritin shumë shpejt. Sa i përket asaj që njëri prej parafolësve e tha që në nëntor është punuar natën, unë e them që në muajin nëntor dhe në ditën e zgjedhjeve nuk është mirë të punohet ngase ndodh të ketë ngrica të asfaltit në ato rrugë e që tani neve si qeverisje e re na është dashtë të heqim asfaltet në disa prej atyre rrugëve që i keni shtruar ju në të kaluarën, prandaj nuk është mirë natën të punohet sepse tani neve po na duhet të merremi sërish me të njëjtat punë, prandaj nuk është koha tani që të punohet natën dhe po ashtu janë kushtet natyrore / klimatike në të cilat përcaktohet se kur duhet të shtrohet asfalti, e jo në muajin nëntor dhe natën gjë të cilën sigurisht që ju e dini këtë, edhe asambleisti që e ceku e dinë këtë por meqë po dëshiron të thotë diçka në rregull jemi.

z.Kasib Bashota, theksoi, si përreth u etiketova paska nga bashkëvendësi im (fjala është për z.Demokrat Hodolli) me të cilin dëshiroj të replikoj paksa por pa inate. Unë kam mbi 500 vota por i kam vota të forta, edhe në Llapashticë të Epërme kam pas shumë vota edhe pse bashkëvendësi im ka dhënë dreka, prandaj unë edhe e ngriti zërin për secilën çështje. Nuk i kam shkruar askujt qoftë me Facebook të rremë e as në ndonjë mënyrë tjetër të pistë edhe pse mua mu kanë bërë gjëra të tilla dhe jam sulmuar në mënyrën më çnjerëzore prej oponentëve të ndryshëm politik, mirëpo për 22 vite ne e dimë se çfarë është bërë për Llapashticën e Epërme nga partia e tij dhe përse janë kthyer 2 milion euro suficit dhe përse nuk është bërë më shumë për këtë fshat i cili është një prej fshatrave më të mëdha dhe jam në dijeni se ndriçimi publik do të vazhdoj të shtrihet për 17 km, mirëpo është e pamundshme të kryhet në një afat të shkurtër kohor, kur ja shtojmë kësaj edhe dëshirat dhe kërkesat e lagjeve dhe familjeve tjera për ndriçim publik.

Mirëpo edhe kjo punë do të kryhet me faza – faza, dhe fshatit Llapashticë do t’i jepet haku ashtu siç e ka meruar edhe në luftë edhe në paqe.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, drejtori i DBF për momentin nuk është prezent por sërish dua të parashtoj një pyetje sepse dje në mbledhjen e KPF-së e ka thënë se është pesëfishuar buxheti për arsim, mirëpo a mendon drejtori që buxheti i ndarë në pikën 5 është i mjaftuar për kabinete shkollore sepse unë mendoj se nuk mjafton ai buxhet për pajisje cilësore në kabinete shkollore.

Sa i përket fshatit Llapashticë, krejt jemi në dijeni sa është punuar dhe çka është punuar.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, vetëm një replikë me Kryetarin e Komunës i cili sa isha jashtë për pak minuta më paska apostrofuar rreth punëve të kryera natën, i them Kryetarit se ne juve ju kemi marrë shembull për punët e kryera natën dhe për këtë mund të ballafaqohemi edhe me fakte dhe video që janë bërë gjatë natës duke u kryer punë asfaltim.

z.Burim Hasani, theksoi, dëgjova disa probleme të cilat u ceken për arsim, shëndetësi e të tjera por edhe në bazë të vendeve dhe lokaliteteve ku u përmenden disa probleme mirëpo unë dëshiroj të paraqesë një problem sepse nuk kam vërejtur ndarje buxhetore për zhvillimin e projektit për kapjen e qenve endacak, kastrimin, sterilizimin dhe vaksinimin e tyre, problem ky i cili prek një numër të madh të problemeve në Komunën e Podujevës e në veçanti në qytet ku ka një numër të madh të qenve endacak duke theksuar oborrin e emergjencës, në hapësira shkollore, nëpër trotuare por po ashtu edhe nëpër fshatra të ndryshme e që vazhdimisht po ka probleme dhe po ka rritje të numrit të qenve endacak e që për këtë çështje nuk kam vërejtur ndonjë ndarje buxhetore për ndonjë projekt duke pas parasysh se në shumë komuna të Kosovës ka projekte të tilla. Në vitin e kaluar ka qenë një projekt dhe ka pas një ndarje buxhetore edhe pse shumë e vogël për këtë problematikë.

Kërkoj që për një projekt të tillë të parashihen mjete buxhetore për 4-5 vitet e ardhshme sepse vërtetë kemi problem shumë serioz me qentë endacak.

Po ashtu problem tjetër kemi edhe mos planifikimin e buxhetit nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, edhe pse janë paraparë disa projekte të mira, por nuk është planifikuar projekt për mbarësimin e kafshëve e që pothuajse në 80% të komunave të Kosovës një projekt i tillë është planifikuar të realizohet, kurse në Komunën e Podujevës që 20 vite nuk është bërë, as në vitin e kaluar e as tani për këtë vit nuk ka planifikim për mbarësimin e kafshëve, projekt i cili do të mund ta rriste efikasitetin dhe numrin e kafshëve në rajonin e Podujevës, sikurse që mund të ishte edhe projekti për mirëmbajtjen dhe pastrimin e thundrave tek blektorët.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, vetëm dëshiroj të paraqes këtë video ku shihet që në fund të muajit tetor më datë 23, duke u shtruar nga qeverisja aktuale asfalt natën në fshatin Gllamnik. (paraqet një video dhe kërkon nga kameramanët që ta fokusojnë atë).

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sot për arsye që kemi çështjen e buxhetit ndoshta edhe lejuam shkeljen e Rregullores së Punës së Kuvendit disa herë sa i përket dhënie dhe kohëzgjatjes së fjalës anëtarëve të Kuvendit në kundërshtim me rregullat që parashihen me Rregulloren, mirëpo arsyeja e kësaj ishte që pasi të përfundoj kjo seancë të mos del ndokush dhe të thotë nuk mu dha mundësia të diskutoj për buxhetin.

Në mbledhjet tjera do t'i përmbahemi Rregullores dhe do ta respektojmë në përpikëri qoftë për kohëzgjatje të fjalimeve qoftë marrje të fjalës dhe çështje tjera.

Gjithashtu dëshiroj të ndalem paksa tek arsimi sepse kam punuar gjatë në arsim dhe i di problematikat, konsideroj se tollovitë që janë duke u bërë në qytet bëhen prej njerëzve që janë duke i sjellë fëmijët nga fshatrat në qytet, kjo është një dukuri shumë e keqe dhe njoh shumë njerëz, madje edhe familjarë në fshatin ku jetoj Obrangj që i kam, të cilët e kanë shkollën afër - vetëm rrugën ta kalojnë, por që i sjellin fëmijët e tyre në shkollat e Podujevës "Shaban Shala" ose "Naim Frashëri", dukuri kjo e cila është mirë të ndalohet nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit që do të emërohet, përkatësisht duhet të del me një qëndrim që asnjë nxënës i shkollave të fshatrave që janë ardhë në

qytet të vijnë në qytet, kjo edhe për arsyen se shkollat e fshatrave po mbesin pa nxënës siç janë shkollat e fshatrave Obrangj, Peran, Dumnicë.

Unë kam fakte për këtë që po e them por nuk është mirë të përmenden, mirëpo si dukuri është shumë e shpeshtë.

z.Naim Çunaku, theksoi, Kryesuesi e përmendi Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe shumë mirë që e përmendi sepse kur përmendet Rregullorja në fjalë në rend të parë duhet ta aplikosh vetë si Kryesues i Kuvendi, kur të folësh diçka e ke foltoren dhe duhet të dalësh e jo të flasësh nga vendi aty ku je, pastaj deri sa nga anëtarët e Kuvendit u shtruan pyetje drejtorëve, ti si Kryesues i Kuvendit i'u sugjerove që pyetjet t'i bëjnë me shkrim, mos e ke ngatërruar këtë sepse në debate nuk ka pyetje dhe përgjigje me shkrim, në pikën të ndryshme mund të bëhet një gjë e tillë dhe atë në seancë të rregullt. Pra me Rregullore përcaktohet kur duhet të bëhen pyetjet dhe përgjigjet me shkrim, e jo gjatë diskutimeve për një temë siç është projektbuxheti.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023 / 2024, sipas materialit përkatës të dërguar për këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota PËR, 15 vota KUNDËR dhe asnjë votë TË PËRMBAJTUR, miratohet propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe jemi pajtuar që për këtë Grup të propozohen anëtarë nga të gjitha subjektet politike dhe 2 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, atëherë nëse ndokush nuk diçka rreth kësaj çështje mund të kalojmë me dhënien e propozimeve.

z.Valon Demolli, në emër të Grupit të LDK-së, për anëtar në Grupin punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, propozoi Arjant Topanicën.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të LVV-së, propozoj Fitim Muçollin për anëtar në Grupin për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, meqë Kryesuesi i Kuvendit është nga radhët e subjektit tonë, propozojmë që Kryesuesi të jetë pjesë e Grupit në fjalë në mënyrë që t'iu japim hapësirë edhe Grupeve të subjekteve tjera të përfaqësohen në këtë Grup punues.

z.Burim Hasani, nga radhët e subjektit AAK, propozoj Arbnor Fazliun për anëtar në Grupin punues.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, anëtari i Kuvendit nga radhët e subjektit politik Organizata Balli Kombëtar Demokratik nuk është prezent në mbledhje dhe nuk di se si mund ta propozojmë dhe ta zgjedhim, andaj kemi 4 anëtar të propozuar nga Kuvendi, na duhet edhe 1 anëtar për ta plotësuar numrin si dhe 2 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët propozohen në ditët në vazhdim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit është mirë që të propozohet edhe një anëtar nga radhët e Kuvendit në mënyrë që të miratohet komplet përbërja e Grupit nga radhët e Kuvendit,

kurse 2 anëtarët nga radhët e Ekzekutivit të Komunës mund edhe të sjellën ditëve në vijim. Nëse nuk ka propozime, unë e propozoj znj. Mimoza Abdullahun për anëtare në këtë Grup punues.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri (me 33 vota të anëtarëve sa ishin prezent), ngritët Grupi punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në këtë përbërje:

- 1. Hilmi Hoxha**, Kryesues i Kuvendit, kryesues i Grupit punues
- 2. Arjant Topanica**, nga radhët LDK, anëtar
- 3. Fitim Muçolli**, nga radhët e LVV, anëtar
- 4. Mimoza Abdullahu**, nga radhët PDK, anëtare
- 5. Arbnor Fazliu**, nga radhët AAK, anëtar

Dy (2) anëtar përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët caktohen nga Kryetari i Komunës ditëve në vijim

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0003138/22
Podujevë,
14 janar 2022

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha